



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 8, datë 06.02.2024

PËR MIRATIMIN E NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË QENDRËS KOMUNITARE PËR SHËRBIME SOCIALE TË INTEGRUARA PËR FAMILJEN NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH NGA PNUD TEK BASHKIA DURRËS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Deklaratës së Përgjithshme të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e Drejtave të Fëmijëve, Ligjit nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, VKM-së nr. 658, datë 17.10.2005 “Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”, Udhëzimit nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Qendrat Komunitare Shumëdisiplinore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 195, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024”, Memorandumit të Mirëkuptimit lidhur midis Bashkisë Durrës dhe PNUD - Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim nr.3815 prot., datë 29.04.2022, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ngritjes dhe funksionimit të Qendrës Komunitare për Shërbime Sociale të Integruara për Familjen në Njësinë Administrative Sukth, nga PNUD tek Bashkia Durrës, në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit lidhur midis Bashkisë Durrës dhe PNUD - Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim nr.3815 prot., datë 29.04.2022.

2. Nivelet e pagave të punonjësve të kësaj qendre janë sipas lidhjes nr.5, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 141, datë 28.09.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës”.
3. Financimi i qendrës për vitin 2024 është parashikuar në buxhetin e Bashkisë Durrës të miratuar me Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 195, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024”.
4. Veprimet financiare të kësaj qendre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të të Moshuarve.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të miratojë strukturën organizative dhe rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Qendrës Komunitare për Shërbime Sociale të Integruara për Familjen.
6. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Qendra Ditore e të Moshuarve, Bashkia Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.02.2024





BASHKIA DURRËS
15.02.24 Nr.14927/3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 97 / Prot.
8

Durrës, më 15.02 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.8 datë 06.02.2024 “Për miratimin e ngritjes dhe funksionimit të Qendrës Komunitare për shërbime sociale të integruara për familjen në Njësinë Administrative Sukth nga PNUD tek Bashkia Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

